



Instituti
për
politikë
evropiane.
Shkup

KOMITETI I
HELSINKIT
PËR TË DREJTAT E NJERIUT
I REPUBLIKES SE
MAQEDONSE

RRJETI

23

TRANSPARENÇA

DHE PUBLICITETI:

SFIDË PËR MODERNIZIMIN

E SISTEMIT GJYQËSOR

NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

**TRANSPARENCA DHE PUBLICITETI:
SFIDË PËR MODERNIZIMIN E SISTEMIT GJYQËSOR NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË¹**

Botues:

Instituti për politikë evropiane - Shkup
Komiteti Helsinkit për të drejtat e njeriut i R. së Maqedonisë

Autor:

Dr. Lubica Karamandi Popçevski

Recensente:

Liljana Ivanovska Shopova

Dizajni grafik:

Relativ

Ky dokument është përgaditur në kuadër të projektit Rjeti 23+ me ndihmë financiare nga Unioni Evropian. Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Unionit Evropian.

Përmbajtja:

1.HYRJE	4
2.ÇKA ËSHTË INFORMACION GJYQËSOR?	5
3.TRANSPARENCA DHE PUBLICITETI NË PROCEDURAT GJYQËSORE	5
3.1. E drejta e gjykimit publik kundrejt privatësisë dhe sigurisë	
3.2. Kufizimi i të drejtës së gjykimit publik	
3.3. Obligimi për shqiptimin publik dhe publikimin e vendimeve	
3.4.Çështje tjera të ligjeve procesuale që kanë të bëjnë me transparencën e gjykatave	
4.TRANSPARENCA DHE PUBLICITETI NË PUNËN E GJYKATAVE	10
4.1.Transparenca dhe publiciteti, në përputhje me Ligjin për gjykatat dhe Rregulloren gjyqësore	
4.2. Rregulla të veçanta për sigurimin e transparencës gjatë punës	
4.3. Internet portali i gjykatave në Republikën e Maqedonisë	
5. GJYQËSORI, SHOQËRIA CIVILE DHE MEDIAT	16
5. 1. Metodatat e raportimit nga ana e mediave	
6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	21
7. BIBLIOGRAFIA	23

Ky dokument e analizon kornizën ligjore ekzistuese për sigurimin e sistemit transparent gjyqësor në Republikën e Maqedonisë dhe ofron udhëzime për avancimin e tij. Duke e marrë parasysh faktin se reformat në gjyqësor bëhen edhe nën ndikimin e proceseve ndërkombëtare, në këtë dokument do të bëjmë një vështrim të standardeve kryesore ndërkombëtare dhe tendencave zhvillimore në këtë fushë.

Analiza e detajuar e zbatimit të rregullave dhe problemeve të cilat shfaqen në praktikë në Republikën e Maqedonisë mbetet objekt i një analize tjetër. Analiza nuk e përfshin gjykatën administrative, gjithashtu nuk e përfshin as punën e Këshillit Gjyqësor, edhe pse transparenca në zgjedhjen, avancimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve është supozim thelbësor për gjyqësor kualitativ.

Pushteti gjyqësor, i cili synon fuqizimin e legjitimitetit të pozicionit të vet, si bartës i tretë i pushtetit në një shtet demokratik, doemos duhet t'i respektoj parimet e transparencës dhe publicitetit. Shpeshherë theksohet se “drejtësia doemos duhet të jetë jo vetëm e fituar, por edhe të shihet se është e fituar,”² ndërsa besimi i publikut është tregues i rëndësishëm për statusin e sistemit gjyqësor dhe drejtësinë në shtet. Për fat të keq, raportet e BE-së theksojnë se në Republikën e Maqedonisë pavarësia gjyqësore ka shënuar kthim pas, ndërkohë që ekziston edhe erozioni i besimit publik në institucionet publike.³ Në Raportin e fundit të KE theksohet qartë procesi retrograd në pjesën e jurisprudencës nga viti 2014 dhe shkatërrimi i një dekade të tërë të reformave të suksesshme.⁴ Dy nga prioritetet e theksuara në Prioritetet e Reformave Urgjente, të cilat kanë të bëjnë me jurisprudencën, janë pikërisht në drejtim të fuqizimit të transparencës së gjyqësorit edhe atë në drejtim të strategjive të përmirësuara të komunikimit përmes të cilave Këshilli Gjyqësor dhe gjykatat më të larta do të jenë në mbrojtje të pavarësisë së gjyqësorit, si dhe publikimit të të gjitha aktgjykimeve gjyqësore në afate të arsyeshme të përcaktuara me ligj (me sigurimin e mundësive për kërkimin e plotë dhe qasje më të lehtë).⁵ Raporti i fundit i KE për Maqedoninë e vë në dukje respektimin konsekuent të Prioriteteve të Reformave Urgjente në pjesën e aksesit në internet në praktikën gjyqësor dhe mundësisë së kërkimit.⁶

Nevoja e avancimit të transparencës në gjyqësor theksohet edhe në Komentin e Parimeve Bangalore për veprimet e gjyqësorit, në të cilat jepen udhëzime të cilat përmes mekanizmave të ndryshëm duhet të implementohen në legjislacionet nacionale.⁷

1 Versioni fillestar nga brifit është prezantuar në dialogun për politika, të mbajtur më datë 25.04.2017, në kuadër të Projektit “Rrjeti 23+” në prezencën e përfaqësuesve të kastës gjyqësore, prokurorive, Ministrisë së Drejtësisë.

2 Parimet Bangalore për veprimet gjyqësore të vitit 2002 të KB, neni 3 paragrafi 2.

3 Konkluzionet e Këshillit për procesin e zgjerimit dhe stabilizim asociativ, dhjetor 2015, f. 13.

4 Komisioni Evropian, Raporti për Republikën e Maqedonisë për vitin 2016, nëntor 2016, f. 5

5 Recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues relating to the communications interception revealed in Spring 2015 (i njohur si Raporti i Pribe), f.12 dhe Prioritetet e Reformave Urgjente, qershor 2015 f. 2.

6 Komisioni Evropian, Raporti për Republikën e Maqedonisë për vitin 2016, nëntor 2016 f. 14.

7 Komenti i Parimeve Bangalore për veprimin gjyqësor, i aksesshëm në:

https://www.unodc.org/documents/corruption/publications_unodc_commentary-e.pdf.

Po ashtu, edhe anketat publike në Republikën e Maqedonisë vënë në dukje besimin e ulët ndaj gjyqësorit, kështu që është e logjikshme që Këshilli Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë të konstatojnë rritje të besimit publik si qëllim të tyre strategjik.⁸ Në këtë drejtim, ky dokument jep një kontribut përkatës të shoqërisë civile. Ai, fillimisht e përkufizon nocionin “informacion gjyqësor, e shqyrton transparencën dhe publicitetin në procedurat gjyqësore, zbatimin e këtyre parimeve në punën e gjykatave, si dhe raportin midis gjyqësorit, shoqërisë civile dhe medias.⁹ Në fund jepen propozime për hapat legjislativ dhe praktik në drejtim të avancimit të transparencës dhe publicitetit të sistemit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.

2. ÇKA ËSHTË INFORMACION GJYQËSOR?

Përcaktimi i përmbajtës së nocionit “informacion gjyqësor” e nënkupton rregullimin e regjimit të transparencës dhe qasjen në informacionet e gjykatave. Informacioni gjyqësor nuk nënkuptohet vetëm si informacione të krijuara nga gjyqtarët gjatë punës së tyre, por edhe në informacionet të cilat i kanë në dispozicion gjykatat. Ai i përfshinë edhe informacionet e krijuara ose të shfrytëzua në punën e organeve/trupave udhëheqëse të gjyqësorit, siç është Këshilli Gjyqësor, si dhe dokumentet e krijuara/të paraqitura nga të gjithë personat e përfshirë në procedurat gjyqësore të cilat janë pjesë të shkresave gjyqësore. Qasja në çdo informacion gjyqësor është e ndryshme. Megjithatë, ajo që rekomandohet është se kur rastet tanimë janë kryer përfundimisht, përkatësisht janë vënë ad acta, publikut të gjerë t’i mundësohet qasja në informacionet të cilat i përmbajnë shkresat e lëndëve. Arsyeja është se qasja në informacione nuk guxon të kufizohet për shkak të shkaqeve historike, shkencore ose shkaqeve statistikore, edhe pse padyshim kjo tërheq shumë veprime si anonimizimi, seleksionimi i shkresave të atyre për të cilat nuk lejohet qasja dhe ngjashëm.¹⁰

3. TRANSPARENCA DHE PUBLICITETI NË PROCEDURAT GJYQËSORE

Transparenca e gjykatave, e shprehur përmes seancave publike gjyqësore dhe shqiptimit publik të vendimeve është pjesë e rëndësishme e së drejtës së gjyqësorit të ndershëm. Procedurat transparente, mes tjerash, janë edhe mënyrë për një lloj të caktuar të kontrollit mbi gjyqësorin. Rëndësia e theksuar është vënë në dukje edhe nga Këshilli i Evropës, i cili që në vitin 2003 miratoi Rekomandime për dhënien e informacioneve në media për procedurat penale.¹¹

8 2014 Raporti vjetor i Këshillit Gjyqësor, f. 42-43, Plani Strategjik i Ministrisë së Drejtësisë 2014-2017, pjesa 3.23.1.3, në: Dimitrieva Jasmina, Organizatat joqeveritare dhe gjyqësori – aktivitete për mbikëqyrje, interaksion, bashkëpunim dhe komunikim, Koalicioni i Shoqatave të Qytetarëve “Të gjithë për gjykim të drejtë”, Shkup, viti 2015 f. 9.

9 Republika e Maqedonisë, në vitin 2009, e ka nënshkruar Konventën Evropiane për qasje në dokumente publike, por e njëjta nuk është ratifikuar. Ajo përfshin edhe qasje në dokumente të sistemit gjyqësor, kështu që realisht mund të pritët, me ratifikimin dhe hyrjen në fuqi të saj, të rritet transparenca në sistemin gjyqësor.

10 Me këtë rekomandim ranë dakord edhe gjyqtarët të cilët kanë marrë pjesë në debatin publik “Avancimi i transparencës së gjyqësorit në RM” i cili u mbajt më datë 25 prill 2017.

11 Rekomandimet e potencojnë rëndësinë që mediat të informojnë dhe komentojnë lirshëm për sistemin juridik – penal duke e respektuar prezumimin e pafajësisë, organet gjyqësore dhe të policisë t’u japin mediave informacione të sakta pa diskriminim të tyre, gazetarëve t’u sigurohen ulëse në sallën e gjyqit, incizimi në sallën e gjyqit të jetë në përputhje me ligjin dhe me lejen e organeve relevante gjyqësore, duke i respektuar të drejtat e të gjithë të pranishmëve, gazetarët të kenë të drejtë për marrjen e kopjeve të aktgjykimeve të shqiptuara publikisht etj. Shih: Këshilli i Ministrave, Këshilli i Evropës 10 korrik 2003, Rekomandimi REC(2003) 13 i Komitetit të Ministrave për vendet-anëtare për dhënien e informacioneve përmes mediave në lidhje me procedurat penale.

3.1. E drejta e gjykimit publik kundrejt privatësisë dhe sigurisë

Procedurat para gjykatave të Republikës së Maqedonisë janë publike. Transparenca e procedurave gjyqësore është parim i garantuar me Kushtetutë, i cili në përputhje me nenin 102 të Kushtetutës, mund të kufizohet në rastet e përcaktuara me ligj. Kushtetuta parashikon edhe shqiptim publik të aktgjykimeve, ndërsa transparenca edhe më tej sigurohet edhe me pjesëmarrjen e gjyqtarëve-porotë.¹² Garancitë kushtetuese për gjykim publik plotësohen edhe me dispozitat e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e cila në nenin 6 paragrafin 1 parashikon se gjykimi publik është pjesë e të drejtës më të gjerë të gjykimit të ndershëm. Së këtejmi, në Republikën e Maqedonisë e drejta e gjykimit publik mbrohet me normat më të larta juridike.

Transparenca dhe publiciteti i procedurave gjyqësore garantohet me Ligjin për gjykata si një parim fundamental (neni 6 paragrafi 2 dhe neni 10), ndërkaq më hollësisht është elaboruar në ligjet përkatëse.¹³ Edhe pse transparenca e procedurave gjyqësore është e garantuar, megjithatë në praktikë ekzistojnë shumë pengesa për përmbushjen e saj: mospasja akses te gjykatat, mos-informimi,¹⁴ mos-interesimi dhe ngjashëm, ndërkaq gjithsesi problem shumë i vështirë është mosekzistimi i kushteve adekuate hapësinore për gjykim. Njëkohësisht, janë vërejtur raste kur policia gjyqësore nuk i ka lejuar anëtarët më të ngushtë të familjeve të palëve të marrin pjesë në gjykime publike ose gazetarëve u ka kërkuar leje të posaçme.¹⁵

Praktika tregon se detyrimi normativ i transparencës së gjykimit mbetet garanci e zhveshur nëse nuk janë përmbushur kushtet e caktuara teknike. **Doemos duhet të ndërmerren masa praktike** në këtë drejtim sepse përvoja çon deri te konstatimi se transparenca ka shkallë të lartë të besimit atëherë kur lëndët mbikëqyren nga publiku.¹⁶

12 Neni 103 paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës.

13 Përkatësisht, Ligji për procedurë penale në nenin 5 gjykimin publik e vendos në kuadër të së drejtës për gjykim të drejtë, e që bëhet parim themelor i procedurës penale, ndërsa më tutje në mënyrë eksplicite parashikohet se seanca kryesore është publike (neni 353 paragrafi 1 i LPP). Përjashtimi i publikut, në kundërshtim me ligjin, paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale (neni 415 paragrafi 1 pika 4). Ngjashëm me këtë, Ligji për procedurë kontestimore gjykimin publik e pozicionon në parimet themelore të procedurës (neni 4), ndërsa LPK seancën kryesore e përcakton si publike (nenet 292 dhe 296). Rregullorja gjyqësore e bën plotësimin me atë që parashikon mundësinë që gazetarët – raportuesit dhe qytetarët të marrin pjesë në seanca publike para gjykatave pa pasur leje paraprake nga gjykata (neni 104 paragrafi 1).

14 Pjesëmarrësit në debatin publik me temë: "Avancimi i transparencës së gjyqësorit në RM" i cili u mbajt më 25 prillit të vitit 2017, theksuan se mos-informimi është pengesë serioze, përkatësisht personat e interesuar nuk kanë akses deri te informacioni për të drejtën e tyre për ta ndjekur gjykimin dhe si mund ta realizojnë këtë të drejtë.

15 Stojanovski Voislav dhe Neda Čalovska, Të drejtat dhe liritë themelore civile dhe politike, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shkup, 2014, f. 29-32.

16 Dimitrieva Jasmina, Organizatat joqeveritare dhe gjyqësori – aktivitete për mbikëqyrje, interaksion, bashkëpunim dhe komunikim, Koalicioni i Shoqatave të Qytetarëve "Të gjithë për gjykim të drejtë", Shkup, viti 2015 f. 30.

E drejta e gjykimit publik, megjithatë nuk është absolute. Kushtetuta e parashikon përjashtimin, por vetëm në raste të përcaktuara me ligj. Gjithashtu, KEDNJ parashikon përjashtime nga e drejta e gjykimit publik në rastet kur bëhet fjalë për moralin, rendin publik, sigurinë nacionale, interesat e të miturit, mbrojtjen e jetës private ose kur një gjë e këtillë mund t'i shkaktoj dëm interesave të drejtësisë.¹⁷

Ligji për procedurë penale ngërthen më shumë dispozita sa i përket përjashtimit të publikut edhe atë të një pjese ose gjatë gjithë seancës kryesore, ndërsa me këtë rast, në nenin 354 për përjashtimin e publikut, parashikohen më shumë shkaqe nga ato të GJEDNJ kështu që parashikohet se edhe kur bëhet fjalë për **fshehtësi zyrtare ose afariste** të mund të përjashtohet publiku.¹⁸ Megjithatë, duhet të merret parasysh **se drejtësia është çështje e interesit publik**,¹⁹ prandaj përjashtimet e gjykimeve publike duhet të reduktohen në atë minimum i cili është i domosdoshëm për ruajtjen e vlerave të një shoqërie demokratike në të cilën sundon e drejta. Ekzistimi i fshehtësisë afariste tanimë është bazë për përjashtimin e publikut në procedurën civile, gjë që është e kuptueshme. Megjithatë, në procedurën penale, ku interesi i publikut dhe rëndësia e mbrojtjes penale – juridike janë shumë më të mëdha, duhet të mendohet se **a duhet të mbetet si bazë për përjashtimin e publikut**. Duhet të theksohet se, përkrah asaj që LPP në nenin 355 paragrafin 2 e lejon prezencën e punonjësve zyrtarë, të punonjësve shkencorë ose publikë në seancë gjyqësore në të cilën është përjashtuar publiku për shkak të dëshmitarit të mbrojtur, megjithatë në praktikë gjyqtarët nuk e lejojnë një gjë të këtillë.²⁰ TKjo, padyshim hedh dyshim mbi parimin e gjykimit të ndershëm dhe të drejtë sepse jo rastësisht Ligji absolutisht nuk e përjashton publikun. **Duhet të ndërmerren hapa për ndryshimin e praktikës gjyqësore në përputhje me Ligjin.**

Ligji për procedurë kontestimore parashikon përjashtimin e publikut gjatë gjithë seancës kryesore ose për një pjesë të saj, nëse një gjë të këtillë e kërkojnë interesat për ruajtjen e fshehtësisë zyrtare, afariste ose personale, interesat e rendit publik ose shkaqet e moralit (neni 293 paragrafi 1). Ajo që bie në sy është mundësia e nenit 293 paragrafit 2 për përjashtimin e publikut nëse nuk mund të ruhet rendi në sallën e gjyqit e që e hap mundësinë për keqpërdorimin dhe privimin e publikut për informim lidhur me rastin. **Duhet të mendohet për lejimin e kësaj mundësie duke e marrë parasysh se është e palejueshme**

17 Neni 6 paragrafi 1 fjalja e dytë e KEDNJ thotë: "Aktgjykimi shqiptohet publikisht, ndërsa gazetarët dhe publiku mund të përjashtohen gjatë gjithë kohës së procedurës ose të një pjese të procedurës në interes të moralit, rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur një gjë të këtillë e imponojnë interesat e personit të mitur ose mbrojtja e jetës private të palëve në kontest, apo kur një gjë të këtillë gjykata e konsideron si të domosdoshme sepse në rrethana të veçanta publiciteti do të mund t'i shkaktoj dëm interesave të drejtësisë".

18 Përjashtimi i publikut mund të bëhet sipas detyrës zyrtare ose sipas kërkesës së palëve apo të dëmtuarit, ndërsa LPP në nenin 356 parashikon që vendimi për përjashtim të miratohet nga ana e këshillit me vendim i cili duhet të arsyetohet dhe të shpallet publikisht. Në këtë mënyrë, megjithatë, jepet hapësirë për përmbushjen e interesit publik me arsyetimin e shkaqeve për përjashtimin e publikut dhe shpalljen publike të aktvendimit. Në këtë mënyrë, nga njëra anë, kufizohet gjykata lidhur me shfrytëzimin e kësaj mundësie ligjore, ndërsa nga ana tjetër publiku njoftohet me rrjedhën e gjykimit.

19 Këshilli Gjyqësor në Holandë, The judiciary and the media in Netherlands, i aksesshëm në: <https://www.rechtspraak.nl/SiteCollectionDocuments/The-Judiciary-and-the-Media-in-the-Netherlands.pdf>, vizita e fundit më datë 20.03.2017, f. 2.

20 Stojanovski Voislav dhe Neda Çallovaska, Të drejtat dhe liritë themelore civile dhe politike, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shkup, 2014, f. 34-35.

që një gjykatë të mos mund ta mbaj rendin në sallën e gjyqit, përkatësisht në raste të këtilla do të duhet të shtyhet seanca dhe të mbahet atëherë kur do të ketë kushte për gjykim publik. Thjeshtë është e lejueshme që publiku të privohet vetëm në raste të jashtëzakonshme të natyrës specifike, por jo edhe për shkak të mos-organizimit të gjykatës.²¹

Njëkohësisht, perceptimet nga praktika tregojnë se në aktvendimet për përjashtimin e publikut theksohet vetëm baza për shkak të të cilës përjashtohet publiku, pa u dhënë arsye të mjaftueshme për përjashtimin e këtillë.²² Praktika duhet të ndryshohet edhe sa i përket kësaj pjese.

3.3. Obligimi për shqiptimin publik dhe publikimin e vendimeve

Në procedurat gjyqësore në Republikën e Maqedonisë, në përputhje me përcaktimet e nenit 6 të GJEDNJ, shqiptimet e aktgjyqimeve çdoherë janë publike, madje edhe në rastet kur në seancën kryesore është përjashtuar publiku. Njëkohësisht, Ligji për gjykata parashikon obligim të përgjithshëm të gjykatave dy ditë nga dita e përpilimit dhe nënshkrimit të vendimeve të miratuara, të njëjtat të publikohen në ueb-faqen e gjykatës, në mënyrën e përcaktuar me ligj (neni 99 paragrafi 3).

LPP parashikon se “Aktgjykimi shqiptohet dhe shpallet publikisht në emër të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë” (neni 397 paragrafi 2), ndërsa më tutje, përcaktohet se si kryhet shqiptimi i aktgjykimit.²³ Madje edhe kur publiku është përjashtuar nga seanca kryesore, shqiptimi çdoherë është publik, me atë që përjashtimi i publikut lejohet gjatë publikimit të shkaqeve të aktgjykimit (neni 405 paragrafi 4).

LPP e parashikon obligimin e gjykatës që në afat prej dy ditësh, nga përpilimi i vendimeve të publikuara, ato të publikon në ueb-faqen e gjykatës, në mënyrën e përcaktuar me ligj (neni 125 paragrafi 3). Parashikohet akses deri te të gjitha aktgjykimet gjyqësore në formë të shkruar ose elektronike, përveç në rastet kur përjashtohet publiku (neni 126 paragrafi 1 i LPP)²⁴ e që megjithatë është pak e habitshme. Përkatësisht, në përputhje me nenin 405 të LPP shqiptimi i aktgjykimit çdoherë është publik, por jo edhe shkaqet, përkatësisht arsyeimi për vendimin e miratuar. Në këtë rast, **do të ishte i logjikshëm akses absolutisht në të gjitha vendimet me arsyeim jo të plotë ose pa arsyeim tek ato raste ku publiku do të ishte i përjashtuar.**

Ligji për procedurë kontestimore parashikon që nëse publiku është përjashtuar nga seanca kryesore, shqiptimi i aktgjyqimeve çdoherë duhet të lexohet publikisht, ndërsa gjykata të

21 Si në LPP, ashtu edhe në LPK parashikohet që për përjashtimin e publikut të vendos këshilli me aktvendim i cili duhet të arsyetohet dhe të shpallet publikisht, ndërsa kundër aktvendimit për përjashtimin e publikut nuk lejohet ankesë e veçantë (neni 295). Përjashtimi i publikut në kundërshtim me ligjin është shkelje thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore (neni 343 paragrafi 2 pika 1.2), ndërkaq kjo është arsyeja se pse lejohet mjeti i jashtëzakonshëm juridik, përkatësisht revizioni (neni 375 paragrafi 1 pika 1).

22 Recensionin e gjyqtarës Liljana Ivanoska Shopova, kryetare e Gjykatës së Apelit në Shkup.

23 Neni 405 paragrafi 2 i LPP parashikon: “Kryetari i këshillit në prezencë të palëve, përfaqësuesve të tyre ligjor, të autorizuarve dhe mbrojtësit, publikisht do ta lexoj tekstin dhe shkurtimisht do t’i kumtoj shkaqet e aktgjykimit.”

24 Neni 126 paragrafi 1 nga LPP.

vendos nëse dhe në ç'masë të përjashtohet publiku gjatë publikimit të shkaqeve të aktgjykimit (neni 325 paragrafi 3). Njëherësh, është inkorporuar obligimi që aktgjykimi, në afat prej dy ditësh nga dita e përpilimit të tij me shkrim dhe nënshkrimit të publikohet në internet faqen e gjykatës në mënyrë të përcaktuar me ligj (neni 326 paragrafi 4).

3.4.Çështje tjera të ligjeve procesuale që kanë të bëjnë me transparencën e gjykatave

Vlen të theksohet se LPP në nenin 554 u kushton vëmendje edhe rasteve kur në mjetet e informimit publik është transmetuar informacioni për personin për të cilin më vonë me aktgjykim është konstatuar se dënimi ka qenë i pabazë ose privimi nga liria ka qenë i pa bazë apo i paligjshëm, si edhe në rastet kur ka ndryshuar kualifikimi juridik. Në raste të këtilla, neni 554 i LPP e parashikon mundësinë e publikimit të komunikatës për vendimin në fjalë. Kjo zgjidhje ligjore është me rëndësi të madhe jo vetëm për personin të cilit i dedikohet dhe reputacionit të tij, por edhe për publikun e gjerë, por edhe për të gjithë ata persona të cilët punojnë në sistemin e mbrojtjes juridike - penale.

Së këtëjmi, LPP në nenin 563 e parashikon mundësinë e shfrytëzimit të mjeteve për informim publik në rastet kur lëshohet urdhër-arrest dhe njoftim për ndonjë person të caktuar nga ana e MPB. Kjo, gjithsesi është një mundësi e mirë e përcaktuar me ligj, ku në mënyrë eksplicite qëndron se një gjë e tillë bëhet “për shkak të njoftimit të publikut.” Se sa zbatohet kjo duhet të ndiqet dhe analizohet, megjithatë, duke u nisur nga përvoja e një rasti të mëparshëm,²⁵ **gjithsesi se rekomandohet njoftim i detyrueshëm i publikut kur bëhet fjalë për persona të caktuar**, për shembull, bartës të funksioneve publike ose persona të pandehur të përfshirë në vepra penale që kanë të bëjnë me pronën shtetërore.⁶

25 <http://kanal77.mk/%D0%BF%D0%BE%D1%82%D0%B5%D1%80%D0%BD%D0%B8%D1%86%D0%B0%D1%82%D0%BO-%D0%B7%D0%BO-%D1%81%D0%B5%D0%BO%D0%B4-%D0%BA%D0%BE%D1%87%D0%BO%D0%BD-%D0%BD%D0%B5-%D0%B5-%D0%BE%D0%B1%D1%98%D0%BO%D0%B2%D0%B5%D0%BD/>

26 Me qëllim të përmbushjes së interesit më të gjerë publik, në nenin 194-a të Kodit Penal, parashikohet publikimi i aktgjykimit për veprë penale nga grupi i “Veprave penale kundër martesës, familjes dhe rinisë” të kryer mbi fëmijë i cili nuk i ka mbushur 14 vjet me mbrojtjen e të dhënave personale të viktimës. Publikimi bëhet sipas kërkesës së prokurorit publik, ndërsa kjo është veçanërisht e rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

4. TRANSPARENCA DHE PUBLICITETI NË PUNËN E GJYKATAVE

4.1. Transparenca dhe publiciteti, në përputhje me Ligjin për gjykatat dhe Rregulloren gjyqësore

Ligji për gjykatat përmban më tepër dispozita të cilat kanë të bëjnë me informimin e publikut dhe të cilat e tërheqin vëmendjen. Përkatësisht, Ligji për gjykata lejon dhënien e informacioneve nga kryetari i gjykatës ose personi përgjegjës për marrëdhënie me publikun, përkatësisht zëdhënësi i gjykatës dhe parashikohet formimi i detyrueshëm i zyrës për marrëdhënie me publikun. Pastaj, Ligji parashikon më së paku një herë në vit informimin e publikut për rezultatet e punës së gjykatës, e që është e evidente duke e pasur parasysh faktin se përveç raporteve vjetore, deri më tani nuk është shumë e njohur në publik se si përmbushet ky obligim ligjor.²⁷

Gjithashtu, lë përshtypje edhe ajo se Ligji ua ndalon palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë që gjatë zhvillimit të procedurës të japin informacione për rrjedhën, zhvillimin dhe epilogun e procedurës, por vetëm atëherë kur gjykata ka miratuar një ndalim të këtillë. Ky ndalim duket “i zbrazët.” Nga prezantimet e deritanishme mediatike të palëve dhe pjesëmarrësve të shumtë duket se ky ndalim nuk është shqiptuar asnjëherë. Kështu që, në rastet kur nuk përjashtohet publiku, ndërkaq shqiptohet ky ndalim, gjykatësi do të duhej të jep arsyetim për ndalimin i cili nuk guxon ta kufizojë lirinë e shprehjes dhe të drejtën e aksesit deri te informacionet.

Nevoja për informim të drejtë e imponoi ndërmarrjen e më shumë hapave. Së këtejmi, **Rregullorja gjyqësore** kapitullin e pestë ia përkushton komunikimit me palët me personat dhe organet e tjera, ndërsa veçanërisht është i rëndësishëm formimi i zyrës për marrëdhënie me publikun.²⁸ Jo më pak i rëndësishëm është fakti se Rregullorja e parashikon publikimin e detyrueshëm të kohës, vendit dhe lëndës së gjykimit në video-tabelën për njoftime dhe para çdo salle gjyqi. Për fat të keq, ky obligim nuk respektohet plotësisht²⁹ e që është element shqetësues meqë mos-informimi është njëri nga shkaqet i cili e pengon publikun në ndjekjen e procedurave.³⁰

Gjithashtu, Rregullorja gjyqësore e ngarkon kryetarin e gjykatës/personin përgjegjës për marrëdhënie me publikun të caktuar nga kryetari t'i japin informacione publikut për punën e gjykatës, përkatësisht për rrjedhën e procedurës sipas lëndës konkrete “me qëllim të informimit transparent dhe objektiv” (neni 102). Nga ana tjetër, duhet të theksohet se rregullorja ofron mundësi që përgjegjës për marrëdhënie me publikun të mos jetë ndonjë gjyqtar, por një person tjetër i punësuar në gjykatë. Raste të këtilla ka në disa vende,³¹

27 Neni 97 i Ligjit për gjykata.

28 Neni 101 i Rregullores gjyqësore.

29 Tomshiq Stojkovska Anica, Efikasiteti gjyqësor dhe realizimi i gjykimit të ndershëm dhe të drejtë, Koalicioni i Shoqatave të Qytetarëve “Të gjithë për gjykim të drejtë”, Shkup, shkurt 2015 f. 24

30 Pjesëmarrësit në debatin publik: “Avancimi i transparencës së gjyqësorit në RM” i cili u mbajt më datë 25 prill të vitit 2017, rekomanduan që gjykatat ta publikojnë me rregull kalendarin e seancave gjyqësore.

31 Në disa vende, të angazhuar për marrëdhënie me publikun janë gjyqtarët nacional/rajonal. Kështu, për shembull është në: Austri, Bullgari, Danimarkë, Angli dhe Uels, në Hungari, Holandë, Norvegji, Poloni dhe Rumania. Në Itali, Angli dhe në Skoci nuk ka gjyqtarë lokal të angazhuar për marrëdhënie me publikun e që është pasqyrë e juridiksionit gjyqësor. Në Itali zëdhënësi i vetëm nacional nuk është gjyqtar, por person zyrtar i Këshillit të Lartë. Në vendet e tjera, të angazhuar për marrëdhënie me publikun janë të ashtuquajturit nëpunës mediatik ose këshilltarët për komunikime, si në: Irlandë, Lituani apo Skoci.

edhe pse në shumicën e shteteve evropiane, në mënyrë komparative janë kompetent disa të ashtuquajtur pres-gjyqtarë. Së këtejmi, **rekomandohet që personat për marrëdhënie me publikun të kenë takime të rregullta midis tyre në nivel ujetor, me ç'rast do të shkëmbeheshin përvojat e punës, të ekzistojnë rregulla të caktuara për detyrat dhe rolin e personave për marrëdhënie me publikun, të kenë një trajnim ose kurs përkatës për marrëdhënie me mediat dhe gazetarët. Veçanërisht i rëndësishëm është rekomandimi që personat për marrëdhënie me publikun t'i ndjekin mediat dhe të reagojnë përmes ueb-faqeve dhe përmes rrjeteve të tjera sociale.**³² Gjithsesi se rekomandimi i këtillë buron nga nevoja e informimit të drejtë të publikut, ndërsa duke i ndjekur rekomandimet e theksuara në mënyrë të qartë rezultojnë nevoja për ndërmarrjen e hapave konkret në këtë drejtim.³³

Është interesant se neni 93 i Rregullores gjyqësore ua njeh të drejtën e shqyrtimit të dokumenteve/shkresave të lëndës vetëm të palëve dhe **personave të tjerë të cilët kanë interes juridik**, ndërsa për këtë vendos kryetari i kolegjit/trupi gjykues i përbërë prej një gjyqtari, përkatësisht kryetari i gjykatës ose **personi i autorizuar nga ai** kur bëhet fjalë për lëndë të arkivuar. Kjo është një çështje e cila e tërheq vëmendjen dhe për të njëjtën duhet të mendohet. Edhe organizatat qytetare në Maqedoni theksojnë se qasja deri te shkresat e lëndëve duhet të lehtësohet në proporcion me kërkesën për mbrojtjen e të dhënave.³⁴ Me interes për publikun, për shembull, nga aspekti shkencor, mund të jenë shkresat e një rasti të caktuar, veçanërisht për shkak të faktit se praktika gjyqësore tanimë trajtohet si burim i së drejtës. Dëshmia e interesit juridik mund të jetë pengesë, apo të shfrytëzohet si pretekst për kufizimin e qasjes. Zgjidhja e theksuar duhet të mendohet mirë dhe të zgjerohet në mënyrë përkatëse rrethi i personave të cilët do të kenë qasje të caktuar deri te dokumentet/shkresat gjyqësore, veçanërisht në ato të lëndëve të arkivuara.

4.2. Rregulla të veçanta për sigurimin e transparencës gjatë punës

Në vitin 2010 u miratua Ligji për administrimin me lëvizjen e lëndëve nëpër gjykata (në tekstin në vijim LALLGJ), i cili mes tjerash rregullon çështje në aspekt të transparencës së gjykatave. Ligji përmban dispozita të rëndësishme me të cilat (duhet të) sigurohet transparencë më e madhe e gjykatave. Është parashikuar publikimi i vendimeve të plotfuqishme dhe jo të plotfuqishme me anonimizim përkatës, fshirja e vendimeve pas skadimit të afateve të përcaktuara me ligj, si dhe mundësia e shtypjen së vendimeve pa pasur mundësi që të bëhen ndryshime.

Ajo që mund të vërehet në nenin 10 të LALLGJ është se vendimet për rastet në të cilat është përjashtuar publiku nuk duhet të publikohen. Kjo është zgjidhje e cila e bart dyshimin duke e pasur në konsideratë se shqiptimi i aktgjykimeve çdoherë është publik.³⁵ Mbase duhet të

32 Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësor, Justice, Society and the Media, i aksesshëm në:

https://www.enj.eu/images/stories/pdf/GA/Dublin/encj_report_justice_society_media_def.pdf, vizita e fundit më datë 23.03.2017 f. 4-6.

33 Kryetari i Shoqatës së Gjyqtarëve dhe zëvendësi i tij, në debatin publik: "Avancimi i transparencës së gjyqësorit në RM", i cili u mbajt më datë 25 prill të vitit 2017, e potencuan nevojën për rol proaktiv të gjyqtarëve në informimin e publikut.

34 Dimitrieva Jasmina, Organizatat joqeveritare dhe gjyqësori – aktivitete për mbikëqyrje, interaksion, bashkëpunim dhe komunikim, Koalicioni i Shoqatave të Qytetarëve "Të gjithë për gjykim të drejtë", Shkup, viti 2015 f. 29.

35 Gjithashtu, në procedurën civile dhe penale, madje edhe kur përjashtohet publiku, mund t'u lejojehet personave zyrtarë, punonjësve shkencorë dhe publikë të marrin pjesë në seancë (neni 294 nga LPK dhe neni 354 nga LPP).

mendohet për mundësinë e publikimit të aktgjykimeve anonime pa arsyetim. Megjithatë, nga aspekti shkencor ose akademik, për disa persona mund të jetë e rëndësishme se a është miratuar aktgjykim në rastin konkret, a ka qenë aktgjykim me dënim ose me lirim, me çfarë dënime dhe ngjashëm. **Zgjidhja për kufizimin absolut të publikimit të aktgjykimeve, në rastet kur është përjashtuar publiku, ndoshta edhe nuk është zgjidhja më e mirë nga aspekti i transparencës dhe publicitetit.** Në këtë mënyrë, publiku i interesuar do të privohet nga përgjigjja ndaj pyetjes a thua është miratuar vendimi në një rast të caktuar konkret.

Gjithsesi, është mbresëlënëse dispozita e nenit 10 paragrafit 6 me të cilën parashikohet mënyra e publikimit dhe kërkimit të vendimeve gjyqësore në ueb-faqen e gjykatës të rregullohet me akt të pushtetit ekzekutiv, përkatësisht ministrin të Drejtësisë. Duke supozuar se gjatë miratimit të aktit janë konsultuar gjyqtarët dhe personat e tjerë profesionistë, parashtrohet pyetja se si ndiqet zbatimi i LALLGJ, ndërsa në këtë aspekt Ministria a i posedon resurset e nevojshme për ndjekjen përkatëse me qëllim të ndërmarrjes së të masave atëherë kur nuk zbatohet ligji. Përfundimisht, parashtrohet pyetja dhe madje pushteti ekzekutiv, përkatësisht Ministria e Drejtësisë a duhet të jetë kompetente për këtë çështje ose Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë.

Me rëndësi jashtëzakonisht të madhe për gjyqësor transparent është neni 11 i LALLGJ, i cili parashikon se Gjykata Supreme e udhëheq bazën e vendimeve gjyqësore të plotfuqishme dhe të pa plotfuqishme me tekste integrale pa anonimizimin e të dhënave të palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë, ndërsa qasja është e kufizuar. Kjo zgjidhje është plotësisht e kuptueshme duke e pasur parasysh rëndësinë e një baze të këtyllë të të dhënave. Megjithatë, ajo që bie në sy është se ligji i jep autorizime të mëdha kryetarit të Gjykatës Supreme të miratoj akt me të cilin do ta përcaktoj qasjen deri te vendimet gjyqësore, dhe njëkohësisht vet ai të vendos sipas kërkesave të personave të interesuar individual deri te baza e të dhënave.

Meqë nuk kemi informacione për përvojat e deritanishme nga personat të cilët kanë kërkuar qasje deri te praktika gjyqësore, por duke u nisur nga praktikat negative, kur vendosja ka qenë në duart e një personi, ndoshta është mirë të mendohet **përcaktimi i niveleve dhe qasjes deri te praktika gjyqësore të jetë akt i miratuar nga mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme të RM, ndërsa për kërkesat individuale të vendos një këshill i caktuar i Gjykatës Supreme.** Në këtë mënyrë, gjatë vendimmarrjes, do të evitohet mundësia e arbitraritetit eventual të kryetarit të Gjykatës Supreme.

Së këtëjmi, duhet të përmendet se LALLGJ në nenin 13 e rregullon obligimin e zyrës gjyqësore për marrëdhënie me publikun, për dhënien e një ekzemplari të aktgjykimit gjyqësor të publikuar në ueb-faqen e personit të interesuar. Ky obligim mund të përmbushet nën kushtin që aktgjykimi të jetë publikuar në mënyrë të rregullt. Kështu që edhe **kjo zgjidhje duhet të ndryshojë duke e marrë parasysh faktin se nuk bëhet në kohë azhurnimi në ueb-faqen e gjykatave me publikimin e aktgjykimeve. Njëherësh, shtrohet pyetja pse e drejta për fitimin e një aktgjykimi gjyqësor lidhet me publikimin e tij në ueb-faqe kur do të ishte e logjikshme që kjo të lidhet me shqiptimin publik të tij.** Në

këtë kontekst është edhe rekomandimi i Këshillit të Evropës që çdo gazetar të mund të merr një kopje të aktgjykimit i cili është shqiptuar publikisht.³⁶

Në bazë të LALLGJ në vitin 2011 ministri i Drejtësisë miratoi **Udhëzim për mënyrën e publikimit dhe kërkimit të vendimeve gjyqësore në ueb-faqen e gjykatës** në të cilin në detaje është përcaktuar mënyra e anonimizimit të të dhënave të ndryshme të vendimeve gjyqësore.³⁷ Për fat të keq, neni 2 i Udhëzimit në të dhënat e anonimizuara për persona të caktuar (dëshmitar, ekspert, psikolog, etj.) nuk e parashikon të dëmtuarin ose viktimën. A është kjo zgjidhje e qëllimshme ose e paqëllimshme, rekomandohet që i njëjti të rishikohet dhe në këtë kuptim të bëhen ndryshime përkatëse normative. Njëherësh, duhet të mendohet në drejtim që ekspertët a duhet të anonimizohen, duke e marr parasysh faktin se gjykata është e lidhur me miratimin e vendimit me (super) ekspertizë, përkatësisht me konstatimin dhe mendimin e personave profesionistë.

Gjithashtu, ajo që bie në sy është zgjidhja e nenit 4 të Udhëzimit, i cili e parashikon mënyrën e anonimizimit të emërtimeve të organeve të administratës shtetërore, organizatave administrative, institucioneve dhe organeve, si dhe njësisve të vetëqeverisjes lokale. Meqë bëhet fjalë për institucione shtetërore të cilat financohen nga buxheti i shtetit dhe për punën e të cilëve interesi publik është jashtëzakonisht i madh, **duhet të mendohet për intervenim sa i përket kësaj çështjeje**. Përkatësisht, aty ku bëhet fjalë për fshehtësi shtetërore publiku do të përjashtohet, ndërsa ato vendime, konform ligjit nuk publikohen. Kështu që, në të gjitha rastet e tjera **nuk ka justifikim për anonimizimin e emërtimeve të institucionit konkret**. Thjeshtë, publiku ka të drejtë të dijë se kur subjektet shtetërore paraqiten si palë në procedurat gjyqësore.

Se si zbatohet ky Udhëzim, mund të fitohet përshtypja me hapjen e portalit të ri gjyqësor www.sud.mk ku çdo person i interesuar mund të merr informacione nga më të ndryshmit. Në pjesën e vendimeve të gjykatave ka mundësi për kërkimin e vendimeve gjyqësore,³⁸ Ajo që është vërejtur është se bëhet anonimizimi i vendimeve, megjithatë shtrohet dyshimi se sa prej tyre publikohen, përkatësisht sa shpesh bëhet një gjë e këtillë. Gjithashtu, për periudhën 1 janar – 15 mars të vitit 2017 Gjykata Themelore Shkup I publikoi gjithsej 33 lëndë, Gjykata Themelore Shkup II publikoi 23 aktgjykime, Gjykata Themelore Manastir publikoi 456 vendime, Gjykata Themelore Shtip 180, Gjykata Themelore Tetovë vetëm 6 vendime, ndërsa Gjykata Themelore Strumicë 365 vendime.³⁹

Është joreale që dy gjykatat më të mëdha në shtet të publikojnë një numër tejet modest të vendimeve. Shtrohet pyetja, a thua problemi është në resurset e pamjaftueshme

36 Këshilli i Ministrave, Këshilli i Evropës 10 korrik 2003, Rekomandime REC(2003) 13 nga Komiteti i Ministrave për vendet-anëtare për dhënien e informacioneve përmes mediave në lidhje me procedurat penale.

37 Lidhur me këtë çështje, Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësor rekomandon publikimin e aktakuzave me mundësi për kërkimin e tyre, publikimi i një rezymeje të shkurtër të aktgjykimit në rastet me interes të veçantë, si dhe anonimizimi i vendimeve. Thuaja se në të gjitha vendet kryhet anonimizimi i vendimeve, përveç në Angli dhe Uels, ku publikohen emrat dhe vendet.

38 Pjesëmarrësit në debatin publik: "Avancimi i transparencës së gjyqësorit në RM", i cili u mbajt më datë 25 prill të vitit 2017, theksuan se në ueb-faqet e gjykatave janë publikuar vendime të anonimizuara dhe të pa-anonimizuara pa informacion se a janë të plotfuqishme ose jo. Publikimi i këtillë në praktikë krijon konfuzion për publikun profesionist.

39 Të dhënat janë përcaktuar në bazë të aksesit në ueb-faqe më datë 21 mars të vitit 2017.

(kuadri dhe pajisja) dhe/ose në mos-organizimin e kryerjes në kohë të obligimeve ligjore. Organizatat joqeveritare tanimë kanë potencuar se gjykatat ankohen për mungesë të kuadrit (përkatës i cili do të mund ta bart barrën e teknologjisë - TI në gjykata.⁴⁰

Në këtë kontekst, duhet të përmendet se nuk publikohen të gjitha vendimet në të gjitha vendet. Rekomandohet që publikimi të ndërlidhet me vendimet e Gjykatës Supreme, të gjykatave më të larta, si dhe të vendimeve të zgjedhura të rëndësishme, seleksionimi i të cilëve në disa raste i është lënë vet gjyqtarit, në disa vende komitetit të gjyqtarëve, në disa vende të tjera ekzistojnë kriteret për seleksionim, ndërsa në publik ka diskutime edhe për publikimin e të gjitha aktgjykimeve. Nëse bëhet seleksionimi i vendimeve të publikuara, rekomandimi është që atë ta bëjë komiteti i caktuar i posaçëm i gjyqtarëve me shpalljen publike të kriterëve për seleksionim,⁴¹ megjithatë, kjo nuk duhet të thotë kufizim i së drejtës së qasjes deri te informacionet për ato aktgjykime të cilat nuk janë publikuar.

Rikujtojmë se me Prioritetet e Reformave Urgjente për Republikën e Maqedonisë, BE-ja ka rekomanduar publikimin e të gjitha aktgjykimeve dhe kjo është e kuptueshme nga gjendja e aktuale e gjyqësorit dhe qasja e publikut deri te vendimet. Megjithatë, nëse gjykatat me të vërtetë janë të mbingarkuara dhe pa kuadër të mjaftueshëm, ndoshta duhet të mendohet që për aktgjykime të caktuara të jepet vetëm rezyme shumë e shkurtër edhe atë në formular paraprakisht të përcaktuar, si për shembull, në kontestet me vlerë të vogël, ndërsa publiku i interesuar lirisht të mund të merr kopje të aktgjykimit.

4.3. Internet portali i gjykatave në Republikën e Maqedonisë

Praktika nga zbatimi i LALLGJ në internet faqet e mëparshme të gjykatave tregon se sistemi ka qenë i mbingarkuar dhe i ngadalshëm, instrumentet e kërkimit joadekuat dhe pamjaftueshëm efikas.⁴² Rrjedhimisht me këtë u bënë ndryshime, kështu që në ueb-faqen e gjykatave sot janë inkorporuar në një portal të vetëm www.sud.mk.⁴³

Njëkohësisht, nga analizimi i portalit të gjykatave www.sud.mk mund të konstatohet si vijon:

-Informacione jo të plota – në pjesën e legjislacionit, të titulluar si Legjislacioni, nuk janë inkorporuar të gjitha ndryshimet, si për shembull, të Ligjit për këshillin gjyqësor;⁴⁴

-Burime jopërkatëse – në pjesën e legjislacionit janë postuar ligjet të cilët nuk janë nga “Gazeta Zyrtare e RM” që është burimi i vetëm relevant, kur bëhet fjalë për publikun profesionist;⁴⁵

40 Unifikimi i praktikës gjyqësore në Maqedoni: Mundësitë kundrejt sfidave. – Shkup: Qendra për Hulumtime dhe Analiza Juridike, 2015.

41 Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësor, Justice, Society and the Media, i aksesshëm në: https://www.encj.eu/images/stories/pdf/GA/Dublin/encj_report_justice_society_media_def.pdf

42 Unifikimi i praktikës gjyqësore në Maqedoni: Mundësitë kundrejt sfidave. – Shkup: Qendra për Hulumtime dhe Analiza Juridike, 2015, f. 17.

43 Disa faqe të caktuara të gjykatave ishin në funksion deri në muajin prill, 2017. Një pjesë e faqeve të gjykatave patën njoftime me të cilat vihej në duke portali i ri, një pjesë e tyre kishin vetëm informacione të vjetruara.

44 Mungon korrigjimi nga viti 2006 dhe ndryshimet nga viti 2011.

-Janë postuar një numër i konsiderueshëm i titujve (si për shembull, Historiku, Plani strategjik, gjyqësori-TI, Vepra profesionale dhe fjalime, Buletinët, Përmbledhjet) absolutisht pa kurrfarë përmbajtje;⁴⁶

-Gjykata të ndryshme japin të dhëna të ndryshme për atë që është informacion me karakter publik.⁴⁷

Është mirë që në portalin gjyqësor për çdo gjykatë ka listë të informacioneve me karakter publik, si dhe të zëdhënësve kompetent dhe kontakte për informacione për publikun. Megjithatë, faqja e internetit www.sud.mk duhet të azhurnohet me rregull dhe të plotësohet me informacione të unifikuara me interes për publikun. Së këtejmi, **rekomandohet që portali të përmbaj informacione ose linqe për përkthyesit, interpretuesit, ekspertët, vlerësuesit dhe gjyqtarët-porotë. Më tutje, për shërbimet të cilat mund t'i marrin qytetarët nga gjykata, si për shembull, marrja e vërtetimit për mosdënim, si dhe shpjegim për procedurën dhe kushtet formale për marrjen e shërbimit konkret. Mungojnë informacionet për personat të cilët dëshirojnë t'i ndjekin gjykimet publike si mund ta realizojnë të drejtën e tyre, ndërsa në këtë kontekst rekomandohet të jepen sugjerime për njoftimin e tyre për ndjekjen e proceseve gjyqësore me qëllim që, nëse është e mundur, të sigurohet sallë e përshtatshme e gjyqit. Është e domosdoshme që në detaje të sqarohet për atë se cilat informacione gjyqësore janë të aksesshme për publikun, kush dhe si mund të ketë qasje dhe ngjashëm.**

45 Janë postuar ligjet nga ueb-faqja www.pravo.org.mk

46 Për shembull, nëse shkoni në pjesën "Plani strategjik" aty shihet se ka një dokument të titulluar si: "Pasusi i standardizuar Lorem Ipsum", i cili përdoret që nga viti 1500 Gjykata e Apelit Manastir, kur ta hapni dokumentin aty qëndron vetëm "This is a dummy PDF".

47 Për shembull, Gjykata Themelore në Manastir i përfshinë konkurset për punë dhe raportet mujore për punën e gjykatës e që nuk është rast me Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup.

Gjendja momentale e marrëdhënieve midis gjyqësorit dhe shoqërisë civile është në nivel të pakënaqshëm për një shtet demokratik. Edhe pse organizatat joqeveritare theksojnë se vëzhguesit e tyre pranohen në sallat e gjyqit dhe prania e tyre vërehet në procesverbalet, megjithatë ekzistojnë probleme tjera të numërta siç janë të dhënat jopërkatese statistikore për shkak të dobësive me AKMIS,⁴⁸ mungesës së komunikimit, mosbesimit në organizatat joqeveritare dhe ngjashëm. Po ashtu, shoqëria civile e thekson nevojën për strategji për bashkëpunim me organizatat joqeveritare, si dhe krijimin e forumit të rregullt për bashkëpunim dhe diskutim për çështje tematike që kanë të bëjnë me gjyqësorin.⁴⁹

Gjithashtu, marrëdhënia e gjyqësorit dhe mediave është shumë e rëndësishme për afrimin e gjyqësorit deri te qytetarët. Mediat janë mënyra përmes së cilës informohet publiku dhe njihet me çështjet që kanë të bëjnë me gjyqësorin, si dhe janë mekanizëm përmes të cilit fuqizohet ose zvogëlohet besimi në gjyqësor. Për këto shkaqe, është shumë e rëndësi të rregullohen marrëdhëniet midis gjyqësorit dhe mediave.⁵⁰

Në disa vende ka ndonjë formë të rregullave ose protokolleve,⁵¹ ndërkaq në disa të tjera, si për shembull, në Danimarkë çështjet rregullohen me ligj. Pavarësisht se si rregullohen çështjet, sa u përket marrëdhënieve midis gjyqësorit dhe mediave, ato duhet të sigurojnë **informim të plotë dhe të drejtë të publikut për çështjet juridike, përmes prezantimit objektiv dhe të paanshëm të fakteve relevante**. Rregullat duhet të kenë karakter të detyrueshëm intern për gjyqtarët, me qëllim që, në njëfarë mënyre, gjyqësori në publik të flet përmes një zëri.⁵² Njëkohësisht, rekomandohet që rregullat të formulohen në përputhje me përfaqësuesit e kategorive profesionale relevante (gjyqtarë, prokurorë, avokatë), ndërkaq të precizohet lista e sanksioneve në rast të cenimit, si për shembull, ndalim i përkohshëm për akreditim. Azhurnimi i rregullave dhe adaptimi i tyre sipas nevojave, do të ishte e dobishme të bëhet pas takimeve/konferencave të zhvilluara të përbashkëta midis zëdhënësve dhe gazetarëve, ndërkaq rekomandohet edhe shfrytëzimi i anketave midis gjyqtarëve dhe gazetarëve, si mënyrë për marrjen e informacioneve. **Rekomandim i përgjithshëm është që gjyqësori të ketë qasje proaktive mediatike** që do të jetë detyrë e veçantë e këshillit gjyqësor në shtet, me qëllim që t'u ndihmoj gjykatave gjatë kontakteve të tyre me mediat. Gjyqtarët, rreptësisht duhet të kufizohen në deklaratat e tyre publike lidhur me rastet të cilat i udhëheqin, por nga ana tjetër në shumicën e shteteve evropiane vlerësimi mediatik i veprimit individual të gjyqtarëve nuk lejohet.⁵³ Në këtë kuptim, **rekomandohet trajnim për transparencën edhe të gjyqësorit dhe nëpunësve gjyqësorë, por edhe i gazetarëve dhe punonjësve mediatik, publikimi në internet i informacioneve**

48 Mangësitë e AKMIS u përmendën edhe nga Dr. L Lazar Nanev, zëvendëskryetar i Shoqatës së Gjyqtarëve në debatin publik "Avancimi i transparencës së gjyqësorit në RM", i cili u mbajt më datë 25 prill të vitit 2017.

49 Dimitrieva Jasmina, Organizatat joqeveritare dhe gjyqësori – aktivitete për mbikëqyrje, interaksion, bashkëpunim dhe komunikim, Koalicioni i Shoqatave të Qytetarëve "Të gjithë për gjykim të drejtë", Shkup, viti 2015 f. 16-17 dhe 25-30.

50 Gjyqtari Shpend Devaja në debatin publik: "Avancimi i transparencës së gjyqësorit në RM", i cili u mbajt më datë 25 prill të vitit 2017, theksoi se as Kodeksi i Gjyqtarëve, as Kodeksi Etik i gazetarëve nuk përmbajnë dispozita të cilat kanë të bëjnë me sjelljen e përdorimit të mediave sociale. Ai rekomandoi intervenime dhe plotësime përkatëse të kodekseve etike.

51 Belgjika, Holanda, Austria, Hungaria, Bullgaria, Lituania, Norvegjia, Rumania dhe Spanja.

52 Rekomandohen rregulla të ndryshme për gjyqësorin nga ato të prokurorisë publike.

53 Në Austri komentet për punën individuale të gjyqtarëve për lëndë konkrete ndalohen zyrtarisht në media.

të ndryshme me interes për publikun e gjerë, organizimi i ditëve të hapura për gjyqësorin, mundësimi i vizitave të grupeve të organizuara, materiale të posaçëm për nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët dhe ngjashëm.⁵⁴

Këshilli i Evropës, që në vitin 2003, nga faqja e tij rekomandoi trajnim të gazetarëve në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe gjykatat për procedurat gjyqësore.⁵⁵ Nevoja e këtyllë është shprehur fuqishëm tek ne, duke e pasur parasysh faktin se është përcaktuar një numër i vogël i gazetarëve me njohje të mira të problematikës gjyqësore-juridike të cilët raportojnë për temat që kanë të bëjnë me gjykatat.⁵⁶ Në mungesë të informacionit, për atë se deri më tani sa gazetarë kanë ndjekur trajnime nga kjo fushë,⁵⁷ në këtë drejtim i përshëndesim hapat të cilët janë paralajmëruar nga **Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë me Shoqatën e Gazetarëve dhe veçanërisht të organizojnë tryeza të rrumbullakëta dhe takime pune.**⁵⁸ **Rekomandojmë bashkëpunim të vazhdueshëm i cili nënkupton takime të përbashkëta midis gjyqtarëve dhe gazetarëve dhe përpilim të manualëve dhe ngjashëm.**

Në kontekst të kësaj që u tha më lartë, e rikujtojmë obligimin ligjor të Këshillit Gjyqësor të RM “**të kujdeset për reputacionin e gjyqtarëve dhe besimin e qytetarëve në gjyqësor.**”⁵⁹ Në drejtim të fuqizimit të transparencës, në vitin 2016, Këshilli Gjyqësor e promovoi Manualin për komunikim të gjykatave me publikun.⁶⁰ Nga ana tjetër, vet gjyqtarët konsiderojnë se Këshilli Gjyqësor nuk është transparent në punën e tij dhe se rrallëherë e garanton pavarësinë dhe mëvetësinë e gjyqësorit.⁶¹ Rrjedhimisht me këtë, monitorimi i punës së tij tregon se vet Këshilli Gjyqësor nuk është mjaftueshëm transparent dhe i hapur ndaj publikut.⁶² **Gjendja ekzistuese e punëve vë në dukje nevojën e madhe për ndërmarrjen e masave gjithëpërfshirëse në sistemin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, fillimisht sa i përket Këshillit Gjyqësor, ndërsa më pas, mes tjerash, ndërtimit dhe implementimit të një qasjeje strategjike të gjyqësorit për marrëdhënie me publikun.**

54 Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësor, Society and the Media, i aksesshëm në:

https://www.encj.eu/images/stories/pdf/GA/Dublin/encj_report_justice_society_media_def.pdf, vizita e fundit më datë 23.3.2017 f. 17-20.

55 Këshilli i Evropës, Deklarata për dhënien e informacioneve përmes mediave në lidhje me procedurat penale të miratuara nga Komiteti i Ministrave më datë 10 korrik të vitit 2003.

56 Caca – Nikolovska Margarita dhe të tjerë: Analiza e pavarësisë së gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë, Instituti për të Drejtat e Njeriut, Shkup, 2013 f. 121.

57 Publikim veçanërisht i rëndësishëm është Manuali: Dimovski Sashe dhe të tjerë, Transparenca në procedurën penale, Shkup, OSBE, viti 2014.

58 Shih: <http://www.jpacademy.gov.mk/novosti/10156>

59 Neni 31 alineja 15 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor.

60 Manuali për komunikimin e gjykatave me publikun është vendosur në listën e informacioneve me karakter publik, i publikuar nga Këshilli Gjyqësor.

61 Caca – Nikolovska Margarita dhe të tjerë: Analiza e pavarësisë së gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë, Instituti për të Drejtat e Njeriut, Shkup, 2013 f. 74 dhe 77.

62 Instituti për të Drejtat e Njeriut, Raporti i monitorimit për punën e Këshillit Gjyqësor të RM – Raporti nr. 1, Shkup, shkurt 2017.

LPP në nenin 360 në sallën e gjyqit ndalon incizime filmike dhe të televizionit, ndërsa me përjashtim, me leje të kryetarit të Gjykatës Supreme mund të incizohet ndonjë seancë e veçantë kryesore.⁶³ LPP parashikon se, megjithatë, edhe në raste të këtilla Këshilli, për shkaqe të arsyeshme, mund të vendos që pjesë të caktuara të seancës kryesore të mos incizohen. Në praktikë, leja e kryetarit të Gjykatës Supreme nuk respektohet plotësisht, përkatësisht kameramanët largohen pas incizimit të inserteve të shkurtra dhe para seancës kryesore, dhe veçanërisht është e rëndësishme se kjo bëhet pa aktvendim për të njëjtën.⁶⁴

Lidhur me mënyrat e raportimit, faktor i rëndësishëm është fakti se Rregullorja gjyqësore parashikon mundësinë për incizim audio dhe vizual dhe fotografim, të cilët janë të lejueshëm në procedurën penale dhe kontestimore dhe në procedurën sipas kontestit administrativ, me leje përkatëse paraprake.⁶⁵ Kur bëhet fjalë për procedurë penale nevojitet leje edhe për transmetimin publik (ritransmetim). Gjithashtu, bie në sy aktvendimi i cili parashikon pëlqim me shkrim të palëve për incizimin në procedurë kontestimore, e cila gjë vështirë mund të arrihet.⁶⁶ Ndoshta duhet të mendohet të mos kërkohet pëlqimi me shkrim në procedura të caktuara kontestimore, të cilat janë me interes të veçantë publik, për shembull, procedurat për shpifje dhe ofendim të politikanëve ose gazetarëve.

Njëherësh, Rregullorja gjyqësore përmban edhe dispozita për procedurën e fitimit e lejes në fjalë (neni 105). Ndërkaq, është interesant fakti se Rregullorja gjyqësore, në nenin 106 paragrafin 1 në fakt ofron bazë për refuzimin e kërkesës për incizim edhe atë për më shumë shkaqe (interesi dhe besimi i publikut, natyra e rastit, interesi i procedurës, privatësia dhe siguria e pjesëmarrësve në procedurë). Kjo zgjidhje normative duhet të rishikohet meqë Rregullorja ofron arsye të mjaftueshme për kufizimin e incizimit,⁶⁷ kështu që shkaqet e refuzimit të kërkesës **duhet të reduktohen për shkak të sigurisë së pjesëmarrësve në procedurë**, dhe jo të lihet hapësirë për vlerësim subjektiv.

63 Dr. Voislav Stojanovski në debatin publik: "Avancimi i transparencës së gjyqësorit në RM", i cili u mbajt më datë 25 prill të vitit 2017, theksoi se në praktikë i jepet leja për incizim secilit që do të kërkoj, e që është shkelja e parë, pastaj me incizimin shkelet prezumimi i pafajësisë.

64 Stojanovski Voislav dhe Neda Çallovska, Të drejtat dhe liritë themelore civile dhe politike, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shkup, 2014, f. 32-33.

65 Neni 104 paragrafi 2, 3 dhe 4 parashikojnë: Incizimi vizual (video) dhe me zë (audio), njoftim dhe fotografim në procedurë penale dhe transmetimi publik (reproduksion) të incizimit kryhet përmes lejes së kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, sipas mendimit paraprakisht të siguruar nga kryetari i Këshillit, gjyqtarët, sipas mënyrës së parashikuar me ligj. Incizimi vizual (video) dhe me zë (audio), njoftim dhe fotografim në procedurën kontestimore dhe në procedurën sipas kontestit administrativ mund të kryhet sipas lejes së kryetarit të gjykatës, me mendim të siguruar paraprak të gjyqtarit i cili vepron ndaj lëndës dhe me pëlqimin me shkrim të palëve. Jashtë sallës së gjyqit, incizimi dhe fotografimi në godinën e gjykatës mund të bëhet me lejen e kryetarit të gjykatës i cili e administron godinën".

Stojanovski Voislav dhe Neda Çallovska, Të drejtat dhe liritë themelore civile dhe politike, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shkup, 2014, f. 34.

67 Neni 106 paragrafi 3 i Rregullores gjyqësore parashikon: "Incizimi dhe fotografimi në gjykatë mund të ndërpritet ose kufizohet – me kërkesë të palëve, ndërkaq me vendim të gjykatës, në çdo kohë; - nëse me vendim të gjykatës përjashtohet publiku për një pjesë të procedurës ose për një veprim procesual, për shkak të ekzistimit të shkaqeve ligjore; - nëse dëshmitari, i dëmtuarit nga vepra penale e kërkon një gjë të këtyllë, gjatë kohës derisa zgjatë dhënien e dëshmisë së tij; - nëse gjykata gjen se ndonjë pjesëmarrës në procedurë do të mund t'i ekspozohet rrezikut, turpit, shkakimit të dëmit ose do të mund të shfaqen pengesa në zbatimin e masave ligjore të shtrëngimit apo nëse për shkak të natyrës së provave të cilat duhet të prezantohen një gjë e këtyllë është e detyrueshme (dëgjimi i dëshmitarëve të mbrojtur, të mitur etj.)."

Është me rëndësi të theksohet se Rregullorja gjyqësore e parashikon edhe sigurimin e kushteve përkatëse për ekipet e mediave dhe ajo që bie në sy është pajisja e cila përmendet.⁶⁸ Me fjalë të tjera, përveç video – ose TV-kamerave, audio-sistemit dhe fotoaparateve, në mënyrë eksplicite thuhet se ato i fut shtëpia mediatike e cila e ka fituar lejen. Në Rregullore thuhet se edhe **telefonat mobil dhe kompjuterët** si “pajisje për incizim ose pajisje tjetër” “nuk guxojnë të prodhojnë efekte të cilat e tërheqin vëmendjen”. Rregullorja, në mënyrë eksplicite nuk e ndalon përdorimin e tyre, kështu që rezulton se të njëjtat mund të përdoren lirisht, gjithashtu nuk ka dispozita për përdorimin e rrjeteve sociale edhe pse në praktikë të njëjtat përdoren nga subjekte të caktuara në sistemin e jurisprudencës, siç është PSP.

Megjithatë, Gjykata Themelore Shkup 1 Shkup përmban Rregulla të posaçme për sjelljen në gjykatë gjë që është e kuptueshme duke e pasur parasysh kompetencën dhe karakterin e saj në proceset gjyqësore. Po ashtu, edhe pse është theksuar se është dokument jozyrtar, qëllimi i të cilit është vetëm informimi, i njëjti e ndalon që gjatë hyrjes në sallën e gjyqit të mbahen me vete telefona celular, kompjuterë dhe pajisje tjetër e cila mund të incizoj.⁶⁹ Kjo është në kundërshtim me Rregulloren gjyqësore, kështu që nëse në Gjykatën Themelore Shkup 1 janë të nevojshme rregulla të posaçme për publikun, **atëherë duhet të intervenohet me ndryshme në Rregulloren gjyqësore.**

Rregullorja gjyqësore e parashikon mundësinë për punë dhe njoftim në sistem të mbyllur nga ana e televizionit intern (neni 109 i Rregullores gjyqësore), fotografimi, incizimi në gjyq dhe transmetimi publik të bëhet me lejen e kryetarit të gjykatës (neni 110), si dhe fotografimi/incizimi kur bëhet fjalë për incizim në sallën e gjyqit nën udhëheqjen e kryetarit të këshillit/gjyqtarëve (neni 111).

Përvojat komparative në audio – dhe video-incizime janë të ndryshme,⁷⁰ por për pjesën dërmuese vlen rregulli se kufizimet janë më rigorozë për procedurat penale, madje edhe aty ku lejohet incizimi. Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësor rekomandon që atëherë kur lejohet video-incizimi të ndërmerren masa për mos-incizim nga ana e jo-profesionistëve (dëshmitarë, të dyshuar, gjyqtarë-porotë), të mos lejohet transmetimi i drejtpërdrejt,

68 Neni 107 i Rregullores parashikon: "Leja për ndjekjen mediatike të gjykimit nënkupton edhe sigurimin e një salle të përshtatshme gjyqësore. Në sallën e gjyqit sigurohet pjesë e veçantë për ekipet e mediave dhe vëzhguesve, e rrethuar ose e shënuar në mënyrë të veçantë, nëse është e mundur me hyrje të veçantë. Në mënyrë që të sigurohet vendosja në pjesën e rezervuar të sallës së gjyqit, gazetarët dhe vëzhguesit e njoftojnë gjykatën për qëllimin e prezencës. Nëpunësi gjyqësor, përkatësisht pjesëtari i policisë gjyqësore kujdeset që personat të cilët kanë leje të kenë vende të rezervuara, si dhe gazetarët dhe vëzhguesit për prezencën e të cilëve nuk nevojitet leje e posaçme. Me kërkesë të gjyqtarit, nëpunësi gjyqësor, pjesëtari të policisë gjyqësore, gazetari ia jep në këqyrje legjitimacionin e gazetarit dhe e kumton emrin e shtëpisë mediatike për të cilën raporton. Nuk lejohet dhënia e përparësisë për një shtëpi mediatike gjatë dhënies së lejes ose gjatë vendosjes në pjesën e rezervuar në sallën e gjyqit. Shtëpisë mediatike, e cila ka paraqitur kërkesë për leje për ndjekjen mediatike të gjykimit, mund t'i lejohet të fut një video – ose TV-kamerë, një audio-sistem dhe dy fotoaparate (më së shumti me dy objektivë), me atë që secila nga teknikat e përmendura përdoret nga një person." Neni 108 parashikon "Kameramanët dhe fotoreporterët gjatë kohës së incizimit nuk guxojnë të lëvizin, të bëjnë lëvizje ose të marrin pozicionin i cili mund ta tërheq vëmendjen apo ta prish rendin në sallën e gjyqit. Mikrofonat dhe instalimet përkatëse montohen paraprakisht në vendin të cilin e përcakton gjyqtari. Mikrofonat duhet të kenë ndërprerës për shkygje të përkohshme. Pajisjet për incizim dhe pajisjet e tjera (telefona celular, kompjuterë) nuk guxon të prodhojnë efekte të cilat e tërheqin vëmendjen. Pajisja nuk mund të futet ose të nxirret nga salla e gjyqit pa lejen e gjyqtarit ose kryetarit të këshillit".

69 Shih: <http://www.sud.mk/wps/wcm/connect/osskopje1/99fef36f-3c20-4f0a-8a91-56a7fa731684/Pravla+na+odnesuvanje.pdf?MOD=AJPERES&CVID=llvt83H>

të ekzistojnë rregulla të qarta dhe precize për audio – dhe video-incizime.⁷¹

Por, ajo që është veçanërisht interesante janë zgjidhjet komparative sa u përket telefonave celular dhe kompjuterëve. Në më shumë vende ndalohet përdorimi i telefonave celular.⁷²

Rekomandohet përcaktimi i rregullave për lejen e mbajtjes me vete dhe përdorimit të telefonave celular, si dhe pasoja në rast të shkeljes së rregullave. Në përgjithësi, lejohet mbajtja dhe përdorimi i kompjuterëve nga ana e gazetarëve.

Në përgjithësi, lejohet mbajtja dhe përdorimi i kompjuterëve nga ana e gazetarëve.

Njëkohësisht, është vërejtur përdorimi i rrjeteve sociale, si Fejsbuk, Twiter, Flickr, nga ana e gjykatave në disa vende (Danimarkë, Norvegji, Spanjë dhe Lituani) i cili vlerësohet si mënyrë e mirë për përafrimin e sistemit gjyqësor deri te qytetarët, dhe në këtë kontekst, rekomandohet zhvillimi i strategjisë, target-grupeve dhe objektivave për shfrytëzimin e mediave sociale të cilat do të orientohen drejt informimit, arsimimit dhe angazhimit të qytetarëve. Theksohet se gjyqtarët duhet t'i kufizojnë përmbajtjet e jetës personale në rrjetet sociale, me qëllim të ruajtjes së dinjitetit të gjyqësorit,⁷³ ndërsa shkelja e rregullave etike duhet të tërheq masa disiplinore.⁷⁴

70 Kështu, në Bullgari, Rumani dhe Portugali paraprakisht parashikohet ndalimi i mbajtjes së telefonave celular në sallën e gjyqit, ndërsa në Angli dhe në Uels përdorimi i telefonave celular është kundërvajtje. Në disa vende lejohet mbajtja e telefonave celular, por jo edhe përdorimi i tyre për incizim, fotografim ose njoftim (Austri, Danimarkë, Itali, Rumani dhe Turqi). Në Lituani lejohet vetëm incizimi nga ana e palëve për nevojat e tyre. Në Angli nuk lejohet incizimi, përveç në seancat e Gjykatës Supreme të cilat transmetohen në kohë reale. Në Belgjikë, Danimarkë, Portugali, Poloni, Hungari dhe Norvegji audio – dhe video-incizimet në përgjithësi lejohen, përveç në raste individuale për të cilët ka interesim të madh publik. Në Norvegji lejohet incizimi i rasteve civile, por jo edhe i rasteve penale. Në Holandë incizimi lejohet gjatë hapjes së seancës, leximit të aktakuzës dhe kur jepen fjalët përfundimtare. Për pjesët e tjera të seancës vendos gjyqtari. Në Rumani incizimi lejohet vetëm në minutat e parë të rastit. Në Spanjë dhe Suedi incizimi lejohet me kufizime të caktuara. Në Angli, e Uels dhe në Spanjë incizimi zhvillohet me televizor intern, i cili është shumë i shtrenjtë dhe për këto shkaqe, nuk është pranuar nga shumica e vendeve.

71 Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësor, Justice, Society and the Media, i aksesshëm në: https://www.ency.eu/images/stories/pdf/GA/Dublin/ency_report_justice_society_media_def.pdf, vizita e fundit më datë 23.3.2017 f. 10.

72 Ndalimi vlen në Bullgari, Danimarkë, Angli dhe Uels, Hungari, Irlandë, Norvegji, Portugali, Rumani dhe Turqi. Në Austri dhe Irlandë e Slloveni kontrolli i procedurës është lënë në duar të gjyqtarit. Në Lituani lejohet vetëm audio-incizimi, dhe jo edhe video-incizimi me telefona mobil nga ana e palëve. Në Holandë ndalohet fotografime me telefonë dhe në përgjithësi përdorimi i tyre në dy sallat gjyqësore më të mbrojtura në Roterdam dhe Amsterdam. Në Holandë dhe Itali nuk ndalohen telefonat mobil, por përdorimi i tyre mund të kufizohet nga gjyqtarët.

73 Duhet të rikujtojmë se në përputhje me Parimet Bangalore për veprim gjyqësor, gjyqtari duhet të promovojë standarde të larta të sjelljes së gjyqtarit, me qëllim të përforcimit të besimit të gjyqësorit i cili është fundament për ruajtjen e pavarësisë së gjyqësorit. Shih: Parimet Bangalore për veprim gjyqësor nga viti 2002 të KB.

74 Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësor, Justice, Society and the Media, i aksesshëm në: https://www.ency.eu/images/stories/pdf/GA/Dublin/ency_report_justice_society_media_def.pdf, vizita e fundit më datë 23.3.2017 f. 6-11.

Në Republikën e Maqedonisë, sot, ndërmerren më shumë hapa me qëllim të modernizimit të gjyqësorit në përputhje me rrjedhat bashkëkohore për punë më transparente. Megjithatë, kemi më shumë çështje të cilat lënë hapësirë për punë në drejtim të transparencës më të madhe. Së këtejmi, duhet të merret parasysh se rezultatet e sistemit gjyqësor nuk varen vetëm nga gjyqtarët, por nga më shumë faktorë relevantë të cilët drejtpërsëdrejti ose tërthorazi ndikojnë në performansat e gjyqtarëve, dhe me këtë rast edhe në transparencën dhe publicitetin e gjykatave.

Rekomandohet, si vijon:

·Të zbatohet qasje strategjike në gjyqësor për marrëdhëniet me publikun, në përgatitjen e së cilës do të marrin pjesë faktorë relevantë (Këshilli Gjyqësor, gjykatat, Ministria e Drejtësisë, Shoqata e Gjyqtarëve, Avokatëve, Gazetarëve etj.) me çka do të përcaktohen rregullat për marrëdhëniet me qytetarët, organizatat joqeveritare dhe mediat.

·Këshilli Gjyqësor dhe Gjykata Supreme të sigurojnë gjyqësor transparent i cili publikut do t'i flas në një zë, së këtejmi duke e mbrojtur pavarësinë e gjyqësorit, si dhe njëherësh të praktikohet mbajtja e forumeve dhe takimeve të rregullta me shoqërinë civile dhe gazetarët.

Gjykatat, Këshilli Gjyqësor, Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, shoqata të gazetarëve:

·Të ndërmarrin më tepër masa praktike (trajnime të rregullta për transparencën e gjyqësorit dhe nëpunësve gjyqësorë, por edhe të gazetarëve dhe punonjësve të mediave, organizim të ditëve të hapura për gjyqësorin, mundësim të vizitave të grupeve të organizuara, materiale të posaçme për nxënësit e shkollave të mesme dhe studentëve dhe ngjashëm).

·Të ndërmerren masa për sigurimin e kushteve për procedura publike gjyqësore: kushte përkatëse hapësinore, qasje deri te gjykatat dhe sallat e gjyqit për personat me aftësi të kufizuar trupore, informimi i publikut për mundësinë e pjesëmarrjes në procedura gjyqësore publike, trajnime për policinë gjyqësore.

Ministria e Drejtësisë, Kuvendi, gjykatat:

·Të rishikohet nëse “fshehtësia afariste” duhet të mbetet bazë për përjashtimin e publikut në procedurë penale.

·Të rishikohet nëse “mos-mbajtja e rendit” mund të jetë bazë për përjashtimin e publikut në procedura kontestimore.

·Të rishikohet dispozita për qasje në aktgjykime nga neni 126 të LPP, përkatësisht të mundësohet që edhe aktgjykimet në rastet në të cilat përjashtohet publiku të jenë të aksesshme me arsyetim të kufizuar ose pa arsyetim.

·Të parashikohet në LPP njoftimi i detyrueshëm i publikut kur lëshohet urdhër-arrest në raste të caktuara, si për shembull, bartës të funksioneve publike.

·Të miratohen ndryshime konform të cilave përcaktimi i niveleve dhe qasja deri te praktika gjyqësore të jetë akt i miratuar në mbledhje të përgjithshme të Gjykatës Supreme të RM, ndërsa sipas kërkesave individuale të vendos një këshill i caktuar i Gjykatës Supreme;

·Ta ndryshojnë nenin 13 të LALLGJ në kontekst të së drejtës që marrja e aktgjykimit të ndërlidhet me aktgjykimin e shqiptuar publik, dhe jo me publikimin e tij në internet faqe.

·Ta ndryshojnë Udhëzimi për mënyrën e publikimit dhe kërkimit të vendimeve gjyqësore në ueb-faqen e gjykatës, me qëllim që organet e administratës shtetërore dhe institucionet publike të mos anonimizohen, përkatësisht një gjë e këtillë të ndodh vetëm në rastet kur bëhet fjalë për fshehtësi shtetërore.

·Ta rishikojnë mënyrën e publikimit të aktgjykimeve, gjegjësisht për lëndë të caktuara a duhet të publikohen vetëm rezyme të shkurtra, ndërsa publiku i interesuar lirshëm të mund të merr kopje nga vendimi i integral.

·Të miratojnë ndryshime normative, me çka do të zgjerohet rrethi i personave të cilët kanë qasje deri te të gjitha shkresat e lëndëve të arkivuara.

·Ta plotësojnë Rregulloren gjyqësore me dispozita, të dhënat e të cilave detyrimisht duhet të publikohen në portalet gjyqësore, ndërsa e njëjta është e nevojshme për shkak të unifikimit të përmbajtjeve të portaleve të çdo gjykate. Me këtë rast, detyrimisht të parashikohet publikimi i të dhënave për punën financiare të gjykatave dhe për raportin vjetor financiar.

·Ta plotësojnë Rregulloren gjyqësore me dispozitat të cilat parashikojnë organizim dhe përmbajtje të vizitës së grupeve të organizuara të gjykatave. Kështu, do të mundësohet që vizitorët të njihen me lëvizjen e lëndëve përmes gjykatës, proceseve dhe mënyrës së analizës, procedimit të lëndëve, si dhe miratimit të vendimeve gjyqësore dhe afatet e përcaktuar për këtë, fizikisht dhe në mënyrë virtuale për të gjitha instancat e gjykatave.

·Ta plotësojnë Rregulloren gjyqësore, me çka do të përcaktohet obligimi i gjyqtarëve për dërgimin në kontinuitet dhe në kohë të të dhënave deri te zëdhënësi i gjykatës dhe zyra për marrëdhënie me publikun, e cila punon me autorizimin e kryetarit të gjykatës.

·Ta plotësojnë Rregulloren gjyqësore, me qëllim që më gjerësisht dhe në mënyrë më precize të përcaktohet puna e zyrës për marrëdhënie me publikun.

·Ta plotësojnë Rregulloren e punës në atë mënyrë që të parashikohen raporte standarde për monitorimin e LALLGJ.

·Ta ndryshojnë aktvendimin e Rregullores gjyqësore për shkaqet e refuzimit të dhënies së lejes për incizim, përkatësisht të njëjtat të reduktohen në minimum dhe të mos lihet hapësirë për vlerësime subjektive.

·Të parashikojnë rregulla në Rregulloren gjyqësore për përdorimin e telefonave celular, kompjuterëve dhe pajisjes tjetër, e cila mund të incizojë në sallën e gjyqit, dhe veçanërisht nëse nevojitet të vlejnjë rregulla më restriktive për Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup.

Gjykatat:

·Të lejojnë pjesëmarrje të publikut shkencor dhe profesionist në seanca gjyqësore në të cilat është përjashtuar publiku, në përputhje me ligjin. Ta respektojnë obligimin për publikimin e detyrueshëm të vendit, kohës dhe sallës së gjyqit në të cilën zhvillohet gjykimi.

·Personat e emëruar për marrëdhënie me publikun nëpër gjykata të organizojnë takime të rregullta midis tyre në nivel vjetor, me ç'rast do t'i shkëmbejnë përvojat e punës.

·Lejet për incizim në sallat e gjyqit të respektohen plotësisht, dhe të rishikohet vendimi për pëlqimin e palëve për incizimin në procedurë kontestimore

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë

Parimet Bangalore për veprimin e gjyqësorit nga viti 2002 të KB

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

Ligji për procedurë penale

Ligji për procedurë kontestimore

Ligji për administrimin me lëvizjen e lëndëve në gjykata

Kodi Penal

Udhëzimi për mënyrën e publikimit dhe kërkimit të vendimeve gjyqësore në ueb-faqen e gjykatës

Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësorë, Justice, Society and the Media, i aksesshëm në: https://www.ency.eu/images/stories/pdf/GA/Dublin/encj_report_justice_society_media_def.pdf, vizita e fundit më datë 23.3.2017.

Këshilli i Ministrave, Këshilli i Evropës 10 korrik 2003, Rekomandime REC(2003) 13 nga Komiteti i Ministrave të Vendeve-Anëtare për dhënien e informacioneve përmes mediave në lidhje me procedurat penale.

Këshilli i Evropës, Deklarata për dhënien e informacioneve përmes mediave në lidhje me procedurat penale nga Komiteti i Ministrave të datës 10 korrik 2003.

Këshilli Gjyqësor i Holandës, The judiciary and the media in Netherlands, i aksesshëm në: <https://www.rechtspraak.nl/SiteCollectionDocuments/The-Judiciary-and-the-Media-in-the-Netherlands.pdf>, vizita e fundit më datë 20.3.2017.

Bojarski Llukaz dhe Tilek Evelina, Organizatat joqeveritare dhe gjyqësori – aktivitetet për mbikëqyrje, interaksion, bashkëpunim dhe komunikim – Rekomandime, Koalicioni i Shoqatave të Qytetarëve “Të gjithë për gjykim të drejtë”, Shkup, viti 2015.

Dimitrieva Jasmina, Organizatat joqeveritare dhe gjyqësori - aktivitetet për mbikëqyrje, interaksion, bashkëpunim dhe komunikim – Koalicioni i Shoqatave të Qytetarëve “Të gjithë për gjykim të drejtë”, Shkup, viti 2015.

Dimovski Sashe, Ilievski Jovan dhe Dimitrievski Zoran, Transparenca në procedurën penale, Shkup, OSBE, viti 2014.

Stojanovski Voislav dhe Neda Çallovaska, Të drejtat dhe liritë themelore civile dhe politike, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shkup, 2014.

Valero – Torrijos Julià and Pardo – López María Magnolia, Open – Government, transparency, access and re-use in the Administration of Justice: another turn of the screw needed from the perspective of the Spanish legal framework, i aksesshëm në: https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2748788, vizita e fundit më datë 23.3.2017.

VoermansWim, Judicial transparency furthering public accountability for new judiciaries,bo: Utrecht Law Review, Vol.3, Issues 1 (June) 2007, i aksesshëm në: <https://www.utrechtlawreview.org/articles/abstract/10.18352/ulr.42/>, vizita e fundit më datë: 15.3.2017.

Internet faqe: www.sud.mk; www.osskopje1.mk; www.osskopje2.mk; www.osbitola.mk; www.osstip.mk; www.ostetovo.mk; www.osstrumica.mk; www.ihr.org.mk